



Republika e Kosovës - Republika Kcsova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT  
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE  
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU  
No. prot./Pres. D. / Pres. No. 983  
D  
25.11.2024

DATË/A	25.11.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefat Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Tarifa e mbingarkesës infrastrukturore

Të nderuar,

Dokumenti për Politika Ujore i Qeverisë (2015), përgatitur nga Këshilli Ndërmnistror i Ujit (KNMU) potencon me sa vijon:

**Deklarata e politikave: Ngarkesa për zhvillimin e infrastrukturës**

*'Qeveria kërkon që komunat, në bashkëpunim me ARRU dhe KRU-të, të shqyrtojnë aplikimin dhe mbledhjen e një tarife për zhvillimin e infrastrukturës ujore përveç pagesës së zhvillimit të infrastrukturës komunale (për rrugët, kanalizimin, ndriçimin e rrugëve, etj.). Ngarkesa e zhvillimit të infrastrukturës ujore do të duhej të ishte një tarifë e rregulluar që do të miratohej nga ARRU.'*

Dokumenti i diskutimit publik i janarit 2024, ngriti çështjen e ndërtimeve të shumta që po zhvillohen në Kosovë, të cilat po shkaktojnë sforcim të infrastrukturës që operohet nga KRU-të, për të ofruar shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizimit (grumbullimit të ujërave të ndotur) në nivelet e kërkuara të shërbimit. Aktualisht, ndërtuesit / investitorët mbulojnë koston për rrjetin terciar të furnizimit me ujë dhe kanalizimit brenda zonës së ndërtimit, dhe këto asete pastaj miratohen nga KRU-të. Me kalimin e kohës, zhvillimi kumulativ do të ndikojë në sforcimin e infrastrukturës së ujit në zonat e sipërme (të larta) dhe të infrastrukturës së ujërave të ndotura në zonat e poshtme (të ulëta). Sipas procesit aktual të përcaktimit të tarifave, ky sforcim i rrjetit, financohet nga të gjithë konsumatorët ekzistues, si zgjerim i infrastrukturës. Dokumenti konsultues, propozoi se kjo nuk ishte kosto reflektive, dhe se një sforcim i tillë duhet të paguhet nga ndërtuesit që e shkaktojnë nevojën për rritje të kapaciteteve ekzistuese të infrastrukturës. Kjo është në përputhje me taksat infrastrukturore që aplikohen në korniza të tjera rregullatore gjëkund tjetër në botë. Përgjigjet e konsultimit, e mbështetën këtë propozim.

Prandaj, ARRU konfirmon, aplikimin e *'tarifave për mbi-ngarkesë të infrastrukturës'* si pjesë e procesit tarifor nga 1 janari 2026. Tarifat e propozuara janë të përcaktuara në Shtojcën A të kësaj letre. Këto tarifa janë në përputhje me politikën e Qeverisë.

ARRU do të japë një sërë udhëzimesh gjithë-përfshirëse që shpjegojnë se si do të zbatohen tarifat dhe si do të pasqyrohen të ardhurat në llogaritë rregullatore dhe në modelin e përcaktimit të tarifave. Ndikimi i këtyre tarifave do të rezultojë me tarifa më të ulëta për konsumatorët ekzistues.

Me respekt,

### Shtojca A – Tarifat e propozuara

ARRU propozon tarifat për mbingarkesë të infrastrukture për kycjet e reja të jenë me vlera financiare siç janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Për konsumatorët jo-shtëpiak, tarifat do të jenë të njëjta me ekuivalentin e konsumatorëve shtëpiak.

Këto tarifa janë vendosur në nivelet e çmimeve të vitit 2024 dhe do të jenë subjekt i rregullimeve vjetore të inflacionit në përputhje me tarifat e tjera.

Shërbimi	Ngarkesa e përforcimit të rrjetit të vendit për objekt të ri (EUR)
Furnizimi me ujë	130.00
Ujërat e ndotura	95.00